

THIRRJE PËR APLIKIME

MENTOR PËR PJESËMARRËS NË PROJEKT PËR LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Instituti ZIP, me mbështetjen e Ambasadës Gjermane në Republikën e Maqedonisë, hap thirrje për aplikime për mentor, gjegjësisht aktivistë shoqërorë, të rinjë nga bashkësitë etnike, grupe të cënueshme ose bashkësi tjera të pafavorizuara, për program të plotë trajnimi mbi ndërtimin e kapaciteteve për të luftuar korrupsionin, i cili do të fillojë në dhjetor 2017.

Programi i mentorimit është pjesë e një projekti njëvjeçar që synon luftimin e korrupsionit midis të rinjve nga komunitetet e cënueshme ose të marginalizuara, si dhe ndërtimin e partneriteteve me autoritetet lokale në mënyrë që të ofrojë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët.

Programi fokusohet në territorin e Qytetit të Shkupit, me fokus të veçantë në komunitatet: **Shuto Orizarë, Saraj, Butel dhe Gazi Babë.**

Për qëllimet e programit, Instituti ZIP do të angazhojë katër (4) mentor, nga një në çdo komunë:

1 mentor për punë me të rinjtë nga Komuna e Shuto Orizarës

1 mentor për punë me të rinjtë nga Komuna e Sarajit

1 mentor për punë me të rinjtë nga Komuna e Butelit

1 mentor për punë me të rinjtë nga komuna e Gazi Babës

Mentorët do të jenë të detyruar të mobilizojnë pjesëmarrësit nga komunitatet e targetura gjatë kohëzgjatjes së projektit dhe do të shërbejnë si një urë lidhëse mes ekipit të projektit (Instituti ZIP) dhe të rinjve nga komunitatet nga të cilat vijnë.

Mentorët do të marrin kompensim financiar për pjesëmarrjen e tyre në projekt nga ana e organizatorit nëpërmjet mbështetjes financiare të Ambasadës Gjermane në Republikën e Maqedonisë.

[Të gjithë të interesuarit mund të aplikojnë deri më 15 nëntor 2017 \(e mërkurë\).](#)

Aktivitetet do të fillojnë më 1 dhjetor 2017 (e premte).



KRITERIUMET

Kriteriumet për aplikim janë si në vijim:

- Të keni të mbaruar studimet deridiplomike ose post-diplomike;
- Minimum 3 vjet përvojë pune në sektorin joqeveritar;
- Lidhje të forta me bashkësitë në njëri nga këto komuna: Shuto Orizari, Gazi Babë, Butel dhe Saraj;
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës maqedonase dhe angleze si dhe të ndonjë gjuhe tjetër si: gjuhë shqipe, turke ose rome. Çdo grup i bashkësive të ndryshme do të ketë mentor me njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës së grupit.
- Interes i madh, angazhim dhe dëshirë për ndryshim në komunitet.

SI TË APLIKONI?

Në qoftë se i plotësoni kriteriumet për pjesëmarrje, Ju lutemi që të na dërgoni:

- CV-në ose rezimen tuaj, e cila përmban informacione mbi edukimin tuaj (të mesëm apo të lartë), komunën të cilës i përkisni si dhe
- Letër motivimi në të cilën do të specifikoni komunën për të cilën ju aplikoni dhe do të përfshini përvojat tuaja në atë se si duhet mobilizuar pjesëmarrësit në programin e trajnimit të komunitetit tuaj.

Aplikacionin mund ta dërgoni në gjuhën maqedone, shqipe, turke dhe rome në info@zipinstitute.mk, deri më 15 nëntor 2017 (e mërkurë).

Në qoftë se keni pyetje Ju lutemi na kontaktoni në email adresën info@zipinstitute.mk ose në numrin e telefonit 02 2615 98 32.